



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:004223

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05711555

C.nr.146/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. C. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 659.00 euro, jashtë seancës, me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B. C. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, që t'ia kompensojë pagën e 13-të, për vitin 2020, në vlerën e shumës së pagës bazë prej 659.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 26.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurave për kompensimin e pagës së 13-të, në vlerë të kontestit prej 659.00 euro.

Në padi ka theksuar se i njëjti është në marrëdhënie pune te e paditura në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, në cilësinë e Mjekut Specialist dhe realizon pagë bazë prej 659.00 euro. Bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, ka konsideruar se i takon realizimi i pagës së 13-të, për vitin 2020. Ka theksuar se ka kërkuar paraprakisht nga e paditura këtë kompensim, mirëpo e njëjta nuk është përgjigjur në kërkesë dhe nuk ka kryer obligimin që i del nga KKS. Sipas Raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të SHSKUK për vitin 2020, e paditura ka pasur suficit prej 6,043,556.95 euro. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej

659.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 20.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se kërkesës i mungon baza ligjore pasi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021, pra ka përfunduar. Për më tepër, sa i përket mundësive buxhetore të punëdhënësit, ka theksuar se e paditura si institucion shëndetësor i nivelit sekondar/dytësor nuk ka pasur mundësi të bëjë kompensimin e shpërblimit për pagën e 13-të, e për këtë kanë njoftimin nga Shërbimi i Financave brenda Spitalit të Përgjithshëm në Gjiilan dhe njoftimin nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - Spitali i Përgjithshëm në Gjiilan, që dëshmon se për periudhën 2018-2020 asnjëherë nuk kanë pasur buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e institucionit, e aq më tepër për paga dhe mëditje, duke qenë gjithnjë në deficit dhe duke u mbuluar nga Ministria e Financave – Thesari në fundvit për të ekzekutuar pagesën e rregullt të pagave mujore. Në vitin 2020 ka shtuar se për shkak të gjendjes sipas pandemisë Covid-19, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendim për pagesë shtesë e cila kishte ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e shpenzimeve, duke pësuar që në këtë vit të ketë tejkalim të buxhetit. Pretendimin se nga të gjeturat e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të vitit 2020 për SHSKUK shihet se ka pasur suficit, e ka kundërshtuar duke shtjelluar se nuk ka pasur suficit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ndërsa nga kategoritë tjera nuk mund të bëhet pagesa për paga dhe mëditje, pasi është në kundërshtim me Ligjin për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës, nenin 12, paragrafin 6. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është e punësuar te e paditura (fakt i provuar nga vërtetimi nr.01-4266 i dt.21.11.2023 i lëshuar nga SPGJ) dhe paga bazë e tij është 659.00 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, në nenin 17, paragrafi 2 është përcaktuar se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Zbatimi i KKS-së, aplikohet për periudhën 11.06.2018 – 10.06.2021, ndërsa mos realizimi i pagës së 13-të, justifikohet vetëm nëse punëdhënësi provon se në asnjë mënyrë nuk ka pasur

mundësi buxhetore për të kompensuar këtë pagë. Pra, barrën e të provuarit për mundësitë buxhetore e bart punëdhënësi.

Ky interpretim është në harmoni edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.212/2023 të datës 09.10.2023.

Për të provuar mundësitë buxhetore të të paditurës, gjykata ka administruar provat: Njoftimi nr.prot.3823 i dt.21.12.2023 i lëshuar nga Zyra Ligjore e SHSKUK-së; Kërkesa për shtim të kufijve buxhetor për SPGJ-në, nr.01-394 e dt.19.02.2020; Qarkore lidhur me procesin buxhetor dhe orari i dëgjimoreve buxhetore 2018-2020, nr.prot.1666/a i dt.15.08.2017; Njoftimi lidhur me ndarjen buxhetore për paga dhe mëditje nr.01-2970 i dt.25.10.2020 i lëshuar nga SPGJ; dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020, i publikuar në Prishtinë, Korrik 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Sa i përket dokumenteve të brendshme të lëshuara nga SPGJ dhe SHSKUK, gjykata ka vërtetuar faktin se të njëjtit kanë njoftuar që sa i përket mundësive buxhetore në kategorinë paga dhe mëditje, asnjëherë nuk kanë pasur buxhet të mjaftueshëm deri në fund të vitit për të plotësuar nevojat në paga dhe mëditje, ku në tre mujorin e fundit të çdo viti, vazhdimisht kanë pasur deficit në paga dhe këtë e ka mbuluar Ministria e Financave, ndërsa në ekstrakt tabelar kanë pasqyruar dallimin mes buxhetit fillestar dhe buxhetit të shpenzuar.

Sa i përket Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020, të publikuar në Prishtinë, Korrik 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në faqen 23, pikën 3 shihet se është konstatuar se “në vitin 2020, SHSKUK ka shpenzuar 95 % të buxhetit përfundimtar, ose 126,021.739 euro, me një ulje 4 % në krahasim me vitin 2019”. Në ekstraktin tabelar shihet se në vitin 2020 për kategorinë pagat dhe mëditjet, buxheti final ka qenë 76,308,249.55 euro, ndërsa shpenzimet kanë qenë 76,249.758,81 euro.

Nga kjo konstatohet se për 58,490.74 euro, nuk është shfrytëzuar buxheti final nga e paditura sa i përket kategorisë pagat dhe mëditjet.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, vlerësoi se dokumentet e lëshuara nga zyra e financave të SPGJ dhe SHSKUK dhe raporti i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit kanë fuqinë provuese të saktësisë së të dhënave në të, prandaj të njëjtave gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata vlerëson se në këtë rast e paditura e ka provuar se nuk ka pasur mundësi buxhetore për kompensimin e pagës së 13-të, për të punësuarit e saj, ndërsa meqë ky kompensim realizohet vetëm në bazë të mundësive buxhetore, gjykata e refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësit.

Faktin se e paditura nuk ka pasur mundësi buxhetore për këtë kompensim, gjykata e vërtetoi nga dokumentet e theksuara si më sipër, nga të cilat konstatoi se e paditura për vitin 2020 në

kategorinë pagat dhe medijtjet sipas buxhetit fillestar të aprovuar dhe atij të shpenzuar ka pasur deficit, ndërsa sipas buxhetit final dhe atij të shpenzuar ka pasur suficit prej 58,490.74 euro.

Kjo shumë, gjykata vlerëson se nuk paraqet mundësi buxhetore të mjaftueshme për kompensimin e pagës së 13-të, pasi përbën një shumë që në asnjë mënyrë nuk arrin të kompensojë të gjithë të punësuarit e saj, me ç'rast provon se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për këtë kompensim.

Thënë këtë, gjykata vlerëson se është justifikuar mos kompensimi i pagës së 13-të, në mungesë të mundësive buxhetore, pasi sipas bindjes së lirë së gjykatës nga faktet e paraqitura në padi dhe në përgjigje në padi, administrimi i provave një nga një, si dhe ndërlihdja e provave mes vete (njoftimet financiare të të paditurës dhe raporti i auditimit) vlerësohet se suficiti prej 58,490.74 euro, nuk paraqet mundësi buxhetore mbi bazën e së cilës mund të kompensohet paga e 13-të, për të punësuarit e të paditurës.

Nga kjo arsye, gjykata vendosi të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil  
C.nr.146/24, datë 20.05.2024

Gjyqtarja,  
Floriqe Qerimi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.